



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 105/2021

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2020

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 158 të Kushtetutës dhe të nenit 63 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit

Miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit për vitin 2020 sipas dokumenteve të mëposhtme, pjesë përbërëse të tij, si më poshtë:

- a) pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit për vitin 2020;
- b) raporti për zbatimin e buxhetit vjetor 2020 në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivat e realizuar;
- c) raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij për vitin 2020;
- ç) raporti për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontigjencës për vitin 2020;
- d) raporti për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme gjatë vitit 2020.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA